

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS–kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar i kolegjit, Gyltene Sylejmani dhe Jelena Krivokapiq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Y. H., nga ..., të cilin me autorizim e përfaqëson S. N., avokat nga ..., kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a. në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Z. Sh., objekti i kontestit anulimi i vendimit mbi shkëputjen e kontratës së punës, kthimit në punë dhe shpërblimit të të ardhurave personale, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.5559/2017 datë 26.1.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12 qershor 2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.5559/2017 datë 26.1.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.5559/2017 datë 26.1.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa i të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 1627/2014 datë 6.9.2017, në të cilën është aprovuar kërkesa e paditësit nën pikën I të dispozitivit, ndërsa nën pikën II të dispozitivit është anuluar si i kundërligjshëm vendimi i Drejtorit Ekzekutiv të të paditurës, KEK me nr. ..., datë 28.4.2014, me të cilën paditësit i është shqiptuar masa disiplinore shkëputje e kontratës së punës si dhe vendimi i Drejtorit Menaxhues të paditurës me nr. ..., të datës 20.5.2014, me të cilën është refuzuar ankesa e paditësit kundër vendimit të shkallës së parë.

Nën pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës apo në vend tjetër të punës i cili përgjigjet përgatitjes profesionale të paditësit me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës që nga data e largimit nga puna e deri

në kthimin në punë, dhe që paditësit në emër të neto pagave të perealizuara për shkak të largimit të kundërligjshëm nga puna për periudhën prej datës 28.4.2014 e deri më atën 31.5.2017 t'ia paguajë shumën prej 23.505,00 € dhe në emër të kamatës në paga për këtë periudhë shumën prej 2.868,00 €, që arrin shumën e përgjithshme prej 26, 353,00 €, në emër të kontributeve pensionale të paguajë në trustin pensional shumën prej 2,654,00 € dhe të paguajë tatimin në pagë në shumën prej 1.705,00 €, me kamatë ligjore nga data 31.5.2017 e deri në pagesën definitive, krejt këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Nën pikën IV të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë të përgjithshme prej 1,170.00 €.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë e paditura në afat ligjor ka paraqitur revizion, duke goditur të njëjtën për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet revizioni dhe të ndryshohen që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit.

Në përgjigje në revizion e paditura ka propozuar që e njëjta të refuzohet dhe aktgjykimi i goditur të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur ka gjetur se revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi në bazë të kontratës së punës ka themeluar marrëdhënie pune të e paditura në detyrat e punës Zyrtar i Prokurimit dhe atë prej datës 1.6.2013 në kohë të pacaktuar. Ndaj paditësit është iniciuar procedura disiplinore ashtu që me vendimin e arbitrit të paditurës me nr. ..., të datës 28.4.2014, paditësit i është shkëputur kontrata e punës për shkak se me rastet e marra si mostrës të projekteve të prokurimit me nr. ...; ...; ..., të cilat i ka udhëhequr ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik dhe udhëzuesit operativ të Prokurimit Publik, sepse nuk ka kryer procedurat e blerjes për vlera minimale sipas nenit 48 dhe paragrafit 3, nuk është respektuar çmimi i tregut i përcaktuar me nenin 48.4 dhe nuk janë kontraktuar operatorët ekonomik sipas nenit 48.5. Drejtori menaxhues i të paditurës me vendimin e saj nr. ..., të datës 20.5.2014 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar vendimin e arbitrit.

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë vlerëson se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore të shkëputjes së kontratës së punës të paditësit, janë shkelur

dispozitat e nenit 10.1 të Kodit Disiplinor të paditurës, sepse organi disiplinor nuk e ka bërë mbledhjen e dëshmimeve siç parashihet në këtë dispozitë, është bërë shkelja e nenit 10.13 të Kodit Disiplinor, sepse paditësit nuk i është mundësuar që të paraqes mbrojtjen dhe është bërë shkelja e nenit 10.13 të Kodit Disiplinor sepse nuk është thirrur përfaqësuesi i sindikatës. Kjo Gjykatë vlerëson se vetëm konstatimet e auditorit të brendshëm nuk kanë mund të shërbejnë si bazë për marrjen e vendimit për shkëputjen e kontratës së punës së paditësit. Njëherit kjo Gjykatë konstaton se është bërë shkelje e nenit 71 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 pasi që nuk janë respektuar afatet kohore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Sa i përket lartësisë së të ardhurave të humbura dhe vlerësimit të fitimit të humbur gjykata e shkallës së parë ka angazhuar ekspertin financiar Prof. A. B., i cili në raportin e tij me shkrim ka paraqitur shumën e fitimit të humbur që ka pësuar paditësi për shkak të mos realizimit të të ardhurave personale.

Gjykata e shkallës së dytë, në vendosje lidhur me ankesën e të paditurës, të njëjtin ka refuzuar duke pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe njëherit konstaton se në faktin se gjatë tenderimit janë blerë sendet të cilat janë shuma të larta në treg nuk mund të jenë bazë për përgjegjësinë e paditësit pasi që janë respektuar procedurat e tenderimit dhe se paditësi nuk ka bërë shkelje të përcaktuara në nenin 7 të Kodit disiplinor të paditurit dhe me asnjë fakt nuk është vërtetuar se e paditura ka pësuar dëm.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje nga neni 215 të LPK, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë vendosi sipas ankesës të të paditurës ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, për të cilat ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse e të cilat janë të pranuar edhe nga Gjykata Supreme, prandaj edhe thëniet e revizionit në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë dhe në bazë të shkresave të lëndës vërtetohet se paditësi në procedurat e tenderimit për kontratat me vlerë minimale ka respektuar dispozitën e nenit 37 lidhur me nenin 67 të Ligjit të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës(nr. 04/L-042) si dhe dispozitat e nenit 54 të Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik ku janë përcaktuar procedurat për kontratat me vlerë minimale dhe në nenin 54.1 të këtij Udhëzuesi është përcaktuar “se autoriteti kontraktues mund të përdor procedurën me vlerë minimale për çdo kontratë publike vlera e përllëgaritur e

të cilës është më pak se 1.000 €, me dhënien e porosive për blerje në lidhje me prokurimin me vlerë minimale, autoriteti kontaktues duhet të siguroj një konkurrim efektiv, transparente dhe efektivitetit të lartë të përdorimit të fondeve publike. Në bazë të procedurës së zhvilluar të tenderëve të prokurimit publik zyrtari i prokurimit publik ka marrë çmimin më të ulët të tri ofertave ,ndërsa çmimet më të lira në treg siç pretendon e paditura nuk ka qenë konkurrese. Prandaj, edhe thëniet e të paditurës se janë bërë shkelje të procedurave të tenderimit për shkak se ka pasur çmimet më të ulëta në treg janë të pabazuara pasi që si u tha çmimet më të lira nuk kanë qenë konkurrese, por zyrtari i prokurimi këto paditësi ka marrë çmimin më të ulët të tri ofertave sipas procedurave për kontratat me vlerë minimale.

Nga kjo del konstatimi se paditësi nuk ka bërë shkelje të detyrave të punës dhe se në veprimet e të paditurit nuk ka veprime kundër ligjore që mund të kualifikohen si shkelje të detyrave të punës të përcaktuara në nenin 7 paragrafi 1 pika (m) dhe (r) të Kodit Disiplinor të paditurit.

Paditësit i është garantuar e drejta në punë në bazë të nenit 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në asnjë mënyrë kjo e drejtë nuk mund t'i mohohet dhe të cenohet e në rastin konkret meqenëse nuk është vërtetuar shkelja e detyrimeve nga kontrata e punës. Gjykata afron mbrojtje gjyqësore për një shkelje që është garantuar me ligj dhe me Kushtetutë, e që në rastin konkret i janë shkelur paditësit. Në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësi ka respektuar procedurat e Prokurimit Publik të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 dhe rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Nga arsyet e sipër përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 222 të LPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.185/2019, më 12 qershor 2019

Kryetari i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri